



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 495 /2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.07.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Agim Hysa” p.f, të paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit, me Nr. REF-60874-04-05-2018, me objekt: “Blerje mish viçi 2018”, me fond limit 1.249.841 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 25.04.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtori e Spitalit Rajonal, Dibër.

Skualifikimin e operatorëve ekonomik, “Zihni Gjura” p.f dhe “Argent Daci” p.f, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Agim Hysa”, p.f,
Lagjia “Gjok Doçi”, Rruga (Bulevardi) “Eles Isufi”, Kati.1
Godina 3-katëshe në anën e majtë të bulevardit, Peshkopi, Dibër.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtorja e Spitalit Rajonal, Dibër
Bulevardi: “Elez Isufi”, Peshkopi, Dibër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.04.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr. REF-60874-04-05-2018, me objekt: “*Blerje mish viçi 2018*”, me fond limit 1.249.841 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 25.04.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtori e Spitalit Rajonal, Dibër.

II.2. Në datën 25.04.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 08.05.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Zihni Gjura” p.f,	1.195.950 lekë	Kualifikuar
2. “Argent Daci” p.f,	1.213.782 lekë	Kualifikuar
3. “Agim Hysa” p.f,	1.240.575 lekë	Skualifikuar

II.4. Operatori ekonomik ankimues “Agim Hysa” p.f, është njoftuar më datë 08.05.2018 lidhur me klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë:

“Operatori ekonomik nuk ka paraqitur një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. (Sipas V.K.M–së nr.379 datë 11.06.2014), sipas pikës 3, të kapaciteti ekonomik të kërkuara në DST. Por ka paraqitur një përmbledhëse të faturave të paguara gjë që nuk vërteton se subjekti nuk ka detyrime të papaguara për energjinë elektrike”.

“Çertifikata e HACCP e paraqitur nga operatori ekonomik sipas pikës 3, të kapacitetit teknik të kërkuara në DST, nuk është më e vlefëshme, pasi afati i saj është 13.10.2017”.

“Operatori ekonomik. ka paraqitur automjet ATP (sipas librezës së mjetit dhe çertifikatës së pronësisë) dmth automjet transoprti i përzier, që shërben edhe për transport udhëtarësh, dhe jo automjet me dhomë frigoriferike siç është kërkuar në pikën.7, të kapacitetit teknik të DST”.

II.5. Në datën 14.05.2018 operatori ekonomik ankimues “Agim Hysa” p.f, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, duke kërkuar kualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik, personit fizik “Zihni Gjura”, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

Me anë të sistemit elektronik më datë 08.05.2018 nga ana e autoritetit kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal, Dibër jemi njoftuar mbi skualifikimin e ofertës sonë me arsyet përkarëse si më poshtë:

Arsyeja e parë e skualifikimit me pretendimin se: “Operatori ekonomik nuk ka paraqitur një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. (Sipas V.K.M –së nr.379 datë 11.06.2014), sipas pikës 3, të kapaciteti ekonomik të kërkuara në DST. Por ka paraqitur një përmbledhëse të faturave të paguara gjë që nuk vërteton se subjekti nuk ka detyrime të papaguara për energjinë elektrike.”.
Në lidhje me këtë pikë ne si operator ekonomik kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi një vërtetim të firmosur dhe vulosur nga organi kompetent që vërteton qartësisht se subjekti ynë i ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi.

Arsyeja e dytë e skualifikimit me pretendimin se: “Çertifikata e HACCP e paraqitur nga operatori ekonomik sipas pikes 3, të kapacitetit teknik të kërkuara në DST, nuk është më e vlefëshme, pasi afati i saj është 13/10/2017”.

Në lidhje me pikën e dytë të skualifikimit për Çertifikatën HACCCP, ju bëjmë me dije se subjekti ynë me mbarimin e afatit të këtyre çertifikatave ka bërë kërkesë pranë institucionit përkatës për

rinovimin e tyre dhe jemi në pritje për rinovimin e tyre, pasi përmbushim të gjitha kërkesat ligjore për objektin për të cilin ushtrojmë fushën e veprimtarisë.

Arsyeja e tretë e skualifikimit me pretendimin se: “Operatori ekonomik ka paraqitur automjt ATP (sipas librezës së mjetit dhe certifikatës së pronësisë) dmth Automjet Transoprti i Përzier, që shërben edhe për transport udhëtarësh dhe jo automjet me dhomë frigoriferike siç është kërkuar në pikën 7 të kapacitetit teknik të DST”.

Në lidhje me pikën e tretë të skualifikimit për dokumentacionin e automjetit ku thoni që është mjet transporti i përzier që shërben edhe për transport udhëtarësh dhe jo automjet me dhomë frigoriferike, ju bëjmë me dije se në lidhje me këtë pikë sipas dokumentacionit që kemi paraqitur është krejtësisht e qartë se ky automjet është në pronësinë tonë dhe është ATP (që do të thotë është automjet me dhomë frigoriferike sipas kërkesave tuaja) dhe absolutisht nuk shërben për transport udhëtarësh. Shikoni me kujdes dokumentacionin e automjetit dhe nëqoftëse nuk jeni të qartë pyesni te organet kompetente (Drejtoria e Transportit Rrugor) për të dhënat e këtij automjeti se për çfarë shërben dhe që “ATP” do të thotë automjet me dhomë frigoriferike.

Gjithashtu ju bëjmë me dije që në kërkesat tuaja në DST, tek kapaciteti teknik pika 4 keni kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë leje mjedisore për aktivitetin “Thertore bagëtish”.

Nga një verifikim I bërë nga çdo person I interesuar në faqen e QKB-së, në të cilën janë të publikuara licensat për çdo operator ekonomik, rezulton që operatori ekonomik “Zihni Gjura”, të cilin ju e keni kualifikuar në këtë procedurë prokurimi nuk është I pajisur me licensë të tillë (Leje mjedisore për aktivitetin “Thertore bagëtish” ...), pra licensa sipas legjislacionit në fuqi është document juridik që I përket vetëm atij subjekti për të cilin është lëshuar dhe nuk mund të jepet ndonjë subjekti tjetër në çfarëdo forme qoftë. Ju keni shkelur ligjin, duke kualifikuar një operator ekonomik me mungesë dokumentacioni.

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj rivlerësimin e ofertës tonë, duke e kualifikuar atë si ofertë e vlefshme, pasi përmbushim të gjitha kërkesat të parashikuara nga ana juaj në DST në këtë procedurë prokurimi, si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “Zihni Gjura”, pasi nuk përmbush dokumentacionin e plotë ligjor të kërkuar nga ana juaj, në të kundërt do ti drejtohem KPP-së deri në shqyrtimin e plotë të ankesës.

II.6. Në datën 18.05.2018, me shkresën nr.314/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Agim Hysa” p.f, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 25.05.2018, pala ankimuese “Agim Hysa” p.f, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke shtuar objektin ankesës të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor me kërkesa si më poshtë:

- Skualifikimin e operatori ekonomik “Zihni Gjura” nga kjo procedurë prokurimi, pasi nga verifikimi i bërë nga çdo person i interesuar në faqen e QKB-së, në të cilën janë të publikuara licensat për çdo operator ekonomik, rezulton që operatori ekonomik “Zihni Gjura”, të cilin autoriteti kontraktor e ka kualifikuar në këtë procedurë prokurimi nuk është i pajisur me licensë mjedisore, kërkesë e cila është kërkuar nga AK në DST për kualifikimin

e operatorëve ekonomik (Leje mjedisore për aktivitetin “Thertore bagëtish” ...), pra licensa sipas legjislacionit në fuqi është document juridik që i përket vetëm atij subjekti për të cilin është lëshuar dhe nuk mund të jepet ndonjë subjekti tjetër në çfarëdo forme qoftë.

- *Skualifikimin e operatori ekonomik “Argent Daci” nga kjo procedurë prokurimi, pasi pretendojmë se ky operator ekonomik nuk i përmbush të gjitha kërkesat ligjore e teknike të kërkuara nga AK për kualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesmarrës.*
- *Kërkojmë kualifikimin e subjektit tonë si ofertë ekonomike e vlefshme, pasi plotësojmë të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktor të kërkuara në DST.*

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 358/1 prot, datë 05.06.2018, protokolluar me tonën me nr. 999/2 prot, datë 07.06.2018, me objekt “*Informacion*” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Agim Hysa*” p.f, se: “*Operatori ekonomik nuk ka paraqitur një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. (Sipas V.K.M –së nr.379 datë 11.06.2014), sipas pikës 3, të kapaciteti ekonomik të kërkuara në DST. Por ka paraqitur një përmbledhëse të faturave të paguara gjë që nuk vërteton se subjekti nuk ka detyrime të papaguara për energjinë elektrike.”. Në lidhje me këtë pikë ne si operator ekonomik kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi një vërtetim të firmosur dhe vulosur nga organi kompetent që vërteton qartësisht se subjekti ynë i ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në Shtojcën 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.1 gërma “b”, të dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar: “*Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*”.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike për operatorin ekonomik “*Agim Hysa*” p.f, në përmbushje të kriterit sa më sipër ky i fundit ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

“Konfirmim informacioni – OSHEE – Web System”, datë 16.04.2018, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, për abonentin Agim Hysa, me numër kontrate BU0C130007057686, ku jepet informacion në një tabelë analitike lidhur me kryerjen e pagesave të energjisë elektrike që ka bërë ky person për periudhën Mars 2015 – Mars 2018.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa neni 53, pika 3 përcakton: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”*

III.1.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme

III.1.5. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 15.06.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1081/1 prot, me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, drejtuar Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë:

“[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:

- 1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).*
- 2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.*
- 3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.*

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimt bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të 6 mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qëndrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të

Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

- 1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.*
- 2. Konsumatori rezulton debitor.*
- 3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.*
- 4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.*
- 5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]*

III.1.6. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues se operatori ekonomik ankimues “Agim Hysa” p.f, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike një dokument pa numër protokolli dhe të vulosur nga Zyra e Shitjeve të OSHEE-së, pra jo sipas formatit të miratuar dhe të përcaktuar në dokumentat e tenderit, me anë të së cilës nuk vërtetohet se subjekti “Agim Hysa” p.f, nuk rezulton debitor për kontratat e energjisë që ka më OSHEE-në, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe Vendimit të ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”. KPP gjykon se, dokumenti i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk është sipas formatit të miratuar, si dhe i kërkuar nga autoriteti kontraktor, bazuar në pikën 7/c të nenit 26 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, në pikën e sipërcituar të dokumentave standarte të tenderit, ku ka kërkuar në mënyrë eksplicite se për të vërtetuar shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, duhet vërtetim i lëshuar nga OSHEE dhe jo dokumenta të printuara dhe që gjeneron sistemi elektronik i OSHEE-së. Akoma më tej, ky fakt pranohet edhe nga vetë operatori ekonomik ankimues, i cili në parashtrimet me shkrim pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik ndër të tjera pretendon se: “Ka paraqitur një përmbledhëse të faturave të paguara gjë që nuk vërteton se subjekti nuk ka detyrime të papaguara për energjinë elektrike.”

KPP gjykon se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Sh.a është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), nr. 1081/1 prot, me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, për dijeni Komisionit të i Prokurimit Publik, OSHEE sh.a. ndër të tjera sqaron se: “Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur: 1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit. 2. Konsumatori rezulton debitor. 3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste. 4. Konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë”. KPP gjykon se institucioni i OSHEE-së menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis OSHEE-së dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Agim Hysa” p.f, për skualifikimin e padrejtë të tij, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interesin e ankimesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Sa më sipër, pretendimet e ankimesit nuk merren në konsideratë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimesit “Agim Hysa” p.f, se: *“Gjithashtu ju bëjmë me dije që në kërkesat tuaja në DST, tek kapaciteti teknik pika 4 keni kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë leje mjedisore për aktivitetin “Thertore bagëtish”. Nga një verifikim i bërë nga çdo person i interesuar në faqen e QKB-së, në të cilën janë të publikuara licencat për çdo operator ekonomik, rezultoi që operatori ekonomik “Zihni Gjura”, të cilin ju e keni kualifikuar në këtë procedurë prokurimi nuk është i pajisur me licensë të tillë (Leje mjedisore për aktivitetin “Thertore bagëtish” ...), pra licensa sipas legjislacionit në fuqi është dokument juridik që i përket vetëm atij subjekti për të cilin është lëshuar dhe nuk mund të jepet ndonjë subjekti tjetër në çfarëdo forme qoftë. Ju keni shkelur ligjin, duke kualifikuar një operator ekonomik me mungesë dokumentacioni”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me titull “Të drejtat e personit të interesuar”* parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatorit ekonomik ankimesit edhe pas ankimit në KPP rezultoi i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimesi sërisht nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatorit ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundëjt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i ankimesit nuk merren në konsideratë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimesit “Agim Hysa” p.f, se kërkon: *“Skualifikimin e operatorit ekonomik “Argent Daci” nga kjo procedurë prokurimi, pasi pretendojmë se ky operator ekonomik nuk i përmbush të gjitha kërkesat ligjore e teknike të kërkuara nga AK për kualifikimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimit të mësipërm të operatorit ekonomik ankimesit (thema decidendum), referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimesit dhe informacionit të autoritetit kontraktor, KPP konstaton

se krahas dorëzimit të formularit të ankesës drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar gjithashtu edhe Formularin e Ankesës dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, i cili është i njëjtë me formularin dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dorëzuar nga ky i fundit, pjesë e informacionit, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ. Referuar formularit të ankesës dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik krahasuar me pretendimet parashtruar pranë autoritetit kontraktor, KPP konstaton se nga ana e ankimuesit, në ankesën dorëzuar pranë KPP-së është parashtruar një pretendim shtesë lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik *"Argent Daci"* p.f, i cili nuk është parashtruar pranë autoritetit kontraktor në fazën e parë të ankimit administrativ.

III.4.2. Në nenin 63, pika 1, e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, me titull *"Të drejtat e personit të interesuar"* parashikon se: *"Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin."* Në nenin 63, pika 2, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"*, të ndryshuar, parashikohet se: *"Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji."*

III.4.3. Referuar lex specialis, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar strictu senso parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor dorëzohet me shkrim brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në rastin konkret KPP konstaton se, ky i fundit është njoftuar mbi vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik *"Argent Daci"* p.f, më datë 08.05.2018. Në interpretim të nenit 63, pika 2, të lex specialis, afati i ankimit pranë autoritetit kontraktor mbi kundërshtimin e vendimit të mësipërm nis të nesërmen e punës dhe përfundon në ditën e shtatë. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrative, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues në lidhje me pretendimin e mësipërme nuk ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor në respekt të nenit 63 pika 2 të lex specialis si një shkallë e parë e ankimit administrative, por ka parashtruar pretendimin vetëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues pranë K.P.P. në lidhje me pretendimin e mësipërm nuk ka respektuar shkallët e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, çka rrjedhimisht sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga "elementet e domosdoshëm të ankesës" që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja "a", të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 *"Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, ndaj dhe përbën shkak për moshqyrtimin e tyre nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit,

në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. Sa më sipër, KPP gjykon se e drejta e ankimit për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “*Argent Daci*” p.f, për pretendimin e sipërcituar, për shkak se nuk është ezauruar pranë autoritetit kontraktor ka rënë në dekadencë.

Sa më sipër pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, të ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Agim Hysa*” p.f, për procedurën e prokurimit me Nr *REF-60874-04-05-2018*, me objekt: “*Blerje mish viçi 2018*”, me fond limit 1.249.841 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 25.04.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal, Dibër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.999 Prot, Datë 25.05.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha